



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 121

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “ALEANCA PËR BARAZI DHE DREJTËSI EUROPIANE”, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1131 Prot, datë 27.02.2023 me:

Kërkues: Partia politike “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me kryetar z. Valentino Mustaka

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Valentino Mustaka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 2.2.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi

Europiane”, me initiale “ABDE”, me kryetar z. Valentino Mustaka rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj zyre;

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është partia “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane” me shkronja nistore “ABDE”, me adresë Lagjja 17, Rruga “Prokop Sorra”, nr. 978 Durrës;
- b) Kryetari i partisë është z. Valentino Mustaka, me adresë Lagjja 17, Rruga “Prokop Sorra”, nr. 978, Durrës;
- c) Financieri i partisë është z. Valentino Mustaka, me adresë Lagjja 17, Rruga “Prokop Sorra”, nr. 978 Durrës;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Altin Kaso, me adresë, Rruga “Komuna e Parisit”, pallatet 1 Maj, shk.2, ap.73, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me kryetar z. Valentino Mustaka, me shkronjat nistore “ABDE”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI